



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC / GRAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/2024 Nr. i faq./Br.str./No.pg 86

Data/Em./Date 24 / 03 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/2026”), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr. 05/L -108 dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 65 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 24.03.2026, miraton këtë:

### V E N D I M

#### **Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026**

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me nr. prot. 02/7066/26, i datës 005.03.2026 dhe merret vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 dhe 2025, në vitin 2026, në shumën e përgjithshme prej **621,339.62€ (gjashtëqind e njëzet e një mijë e treqind e tridhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e dy cent)**.
- 2. Mjetet**, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të barten në vitin 2026 në këto programe dhe kategori buxhetore:
  - **Nga fondi burimor (21), në shumën prej 621,339.62€:**
  - *Nga fondi burimor (21) në kategorinë e investimeve kapitale në shumën prej 366,000.00€:*
    - 2.1. Në programin: Buxhet dhe Financa (175), nënprogrami: Buxhetimi (17511), kodi funksional: 0112.**
      - 2.1.1. Projekte me bashkëfinancim, kodi: 53782, në shumën prej 100,000.00€.
    - 2.2. Në programin: Shërbime Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia (180), nënprogrami: Infrastrukturë Publike (18171), kodi funksional: 0451.**
      - 2.2.1. Ndërtimi rrugëve Rahovec – Xërxë – Opterushë - Krushë e Madhe – Gexhë – Kramovik – Hoçë; kodi i projektit: 53790, në shumën prej 50,000.00€;
      - 2.2.2. Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në stacionin e autobusëve në Rahovec; kodi i projektit: 49887, në shumën prej 16,000.00€.
    - 2.3. Në programin: Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nënprogrami: Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66360), kodi funksional: 0620.**

2.3.1. Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit, kodi i projektit: 49832, në shumën prej 100,000.00€;

2.3.2. Ndërtimi i kolektorit dhe i shtratit të lumit Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushë e Madhe, kodi i projektit: 55801, në shumën prej 100,000.00€.

**2.4. Nga fondi burimor (21) në kategorinë: Mallra dhe Shërbime, në shumën prej 130,000.00€.**

2.4.1. Në programin: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (730), nënprogrami: Shërbimet e shëndetësisë primare (73700), kodi funksional: 0721, në shumën prej 80,000.00€;

2.4.2. Në programin: Administratë (920), nënprogrami: Administratë (92055), kodi funksional: 0980, në shumën prej 90,000.00€.

**2.5. Nga fondi burimor (21) në kategorinë: Shpenzimet Komunale, në shumën prej 35,339.62€.**

2.5.1. Në programin: Shërbimet Publike, Mbrojtje (180), nënprogrami: Infrastruktura publike (18171), kodi funksional: 0451, në shumën prej 35,339.62€.

**2.6. Nga fondi burimor (21) në kategorinë: Subvencione dhe Transfere, në shumën prej 50,000.00€.**

2.6.1. Në programin: Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi (470), nënprogrami: Bujqësia (47011), kodi funksional: 0421, në shumën prej 50,000.00€.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen ueb zyrtare të Komunës.

**Me vendim të njoftohen:**

- **Kryetari i Komunës,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
- **MAPL-ja, dhe**
- **Arkivi.**

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01 Nr. 124/2026  
Datë: 24.03.2026

  
Fatmir Iska  
Kryesues i Kuvendit